



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5342/12 prot.

Laç, më 01.12 2023

VENDIM

Nr. 31, datë 23/11 .2023

“PËR MIRATIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTIT DHE TË ÇMIMIT, PËR MËSUESIT QË PUNOJNË DHE NXËNËSIT QË MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT TË TYRE”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 01.03.2023 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre”, të shkresës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin nr.798 prot, datë 08.11.2023 “Kërkesë për miratim të hartës së linjave të transportit mësues-nxënës për vitin kalendarik 2024, për IAV të ZVAP-së Kurbin”, si dhe relacionit me nr.5342 prot, datë 16.11.2023 “Relacion për miratimin e linjave të transportit dhe të çmimit, për mësuesit që punojnë dhe nxënësit që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre”, të Drejtorisë së Shërbimeve Publike”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, pas propozimit të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

1. Miratimin e linjave të transportit dhe të çmimit, për mësuesit që punojnë dhe nxënësit që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre për vitin kalendarik 2024, sipas listës bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

- **Prefektit të Qarkut Lezhë.**
- **Drejtoria e Shërbimeve Publike**
- **Arkivi**

SEKRETAR I KËSHILLIT
ARBER LEKA

KRYETAR
EDLIRA LLESHI

